



NEWSLETTER

Prill 2025

Nr.4

Mbikëqyrja e transmetuesve, ORRPKE dhe medias së shkruar

Transmetuesit

Ndaj 89 transmetuesve që transmetojnë programe TV ose programe në radio Agjencia ka kryer dy mbikëqyrje të rregullta administrative. Një mbikëqyrje i referohej detyrimit që deri më 31 mars në formular të veçantë të përcaktuar nga Agjencia të paraqesin të dhëna për strukturën e pronësisë, kryeredaktorin/redaktorët, burimet e financimit në vitin paraprak, të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara në total në vitin paraprak nga veprimtaria e ofruar. Mbikëqyrja e dytë i referohej detyrimit për publikimin e të dhënave për strukturën e pronësisë, kryeredaktorin/redaktorët dhe burimet e financimit në vitin paraprak, në kohën më të shikuar jo më vonë se 31 mars, dhe inçizim të shpalljes t'i dorëzojnë Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit. Gjatë mbikëqyrjeve, u konstatua se të 89 transmetuesit kishin përbushur detyrimet ligjore.

Lidhur me detyrimet për përdorimin e gjuhës në programe, transmetimin ditor së paku 12 orë program në televizion dhe transmetim ditor së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audio ose audiovizuale maqedonase, për respektimin e rregullave gjatë transmetimit të komunikimeve komerciale audiovizuale, mbrojtjen e të miturve nga programet që mund të dëmtojnë zhvillimin e tyre fizik, mendor ose moral, mbrojtjen e të dhënave personale të të miturve, ofrimin e kuizeve ose formave të tjera të pjesëmarrjes në shpërblime, përdorimin e shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar dhe votimin telefonik dhe transmetimin e lojërave të fatit, mbikëqyrje e rregullt programore është kryer ndaj TV Sitel, TV Alsat-M, TV Alfa, TV Kanal 5 dhe TV Telma. Gjatë mbikëqyrjes nuk u konstatuan shkelje të dispozitave të Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Ndaj të njëjtave stacione televizive, është kryer dhe mbikëqyrje e rregullt administrative në lidhje me detyrimet për të publikuar impresium, informacioneve që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve dhe detyrimin për publimim të identifikimit të transmetuesit. Gjatë mbikëqyrjes nuk u konstatuan shkelje të detyrimeve administrative nga Ligji për Median dhe Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Pasi që kaloi afati ligjor për harmonizim ligjor me masat për vërejtje publike, u kryen mbikëqyrje të kontrollit programor ndaj Nasha TV, TV Kompani 21-M, TV Due, TV Njuz dhe Radiotelevizioni të Maqedonisë - Shërbimi i Tretë Programor RTM 3. Gjatë mbikëqyrjeve, u konstatua se TV Due sërish nuk ka respektuar detyrimet për mbrojtjen e të miturve, përkatësisht në programin e transmetuar më 25 mars, para transmetimit të disa programeve të kategorisë së parë, dytë dhe të katërt, është përdorur sinjal paralajmërues i gabuar për mbrojtjen e të miturve, për shkak të së cilës është ngritur procedurë kundërvajtëse.

Gjithashtu u kryen disa mbikëqyrje të jashtëzakonshme me ankesë dhe sipas detyrës zyrtare. Pas një ankese të marrë nga një qytetar, u krye mbikëqyrje e jashtëzakonshme programore mbi edicionin e programit aktual-informativ "Samo vistina", i cili u shfaq premierë në programin e Kanalit TV 5 më 19 mars. Mbikëqyrja përfshinte parimet për kryerjen e veprimtarisë dhe ndalimin e veçantë për nxitjen ose përhapjen e diskriminimit, intolerancës ose urrejtjes bazuar në baza diskriminuese të ndalura. Gjatë mbikëqyrjes nuk u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore.

Sipas detyrës zyrtare, mbikëqyrje të jashtëzakonshme u kryen në TV Telma, TV Due dhe TV Klan Maqedoni. Mbikëqyrja e TV Telma që kishte të bënte me përbushjen e detyrimit për sigurimin e kushteve kadrovike sipas Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike, kushteve për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio, tregoi se kryeredaktori i TV Telma është i punësuar nga transmetuesi në marrëdhënie të rregullt pune dhe me orar të plotë pune. Mbikëqyrja e jashtëzakonshme administrative mbi punën e TV Due tregoi se media në disa programe të transmetuara nuk publikoi të dhëna për impresium, për të cilën iu shqiptua masë vërejtje publike.

Mbikëqyrja e jashtëzakonshme ndaj punës së TV Klan Maqedoni për përbushjen e kushteve minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio tregoi se transmetuesi nuk i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në këtë Rregullore, prandaj u iniciua procedurë për heqjen e lejes për transmetim TV. Pas përfundimit të afatit për harmonizim ligjor, ndaj TV Klan Maqedoni është kryer mbikëqyrje e kontrollit administrativ, e cila tregoi se ende nuk i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregullore, prandaj i është hequr leja për transmetim TV.



NEWSLETTER

Operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore mbi operatorët A1 Maqedoni dhe Telekabel për detyrimin në paketën programore që ata ritransmetojnë detyrimisht dhe papagesë për të ofruar shërbime programore të shërbimit publik radiodifuziv, si dhe për detyrimet për regjistrimin e shërbimeve programore në Agjenci dhe titrimin e programeve që ata ritransmetojnë. Gjatë mbikëqyrjes nuk u konstatuan shkelje.

Ndaj operatorëve Multimedija Network L janë kryer mbikëqyrje të kontrollit programor për të përcaktuar nëse operatori ka vepruar sipas masave vërejtje publike të shqiptuara për shkak të shkeljeve të ndryshme ligjore të detyrimeve gjatë ritransmetimit të shërbimeve programore. Mbikëqyrjet treguan se operatori plotësisht ka vepruar sipas aktvendimeve për ndërmarrje të masës vërejtje publike.

Mediat e shtypit

Agjencia ka realizuar mbikëqyrje të rregullt administrative mbi 19 botues të mediave të shtypit me qëllim për të konstatuar nëse ata kanë publikuar të dhënat për strukturën e pronësisë, të dhëna mbi emrin dhe selinë e personave juridikë ose emrin dhe vendin e banimit të personave fizikë që janë pronarë të aksioneve ose pjesës-marrës në botuesin e medias, mbi të dhënat për përqindjen e aksioneve ose pjesës së fituar dhe datën e marrjes, së paku në një gazetë ditore, një herë në vit, jo më vonë se 31 marsi i vitit aktual, dhe nëse drejtuar Agjencisë kanë dorëzuar fragment të shpalljes në afat prej 15 ditësh nga dita e shpalljes. Mbikëqyrja tregoi se mediat e shtypit i kanë përmbushur detyrimet ligjore.

Masat e shqiptuara vërejtje publike

Këshilli i Agjencisë, në seancën e 18-të mbajtur më 24 prill, në bazë të konstatimeve nga mbikëqyrja e rregullt programore, shqiptoi masë vërejtje publike ndaj TV 24 Vesti për mosrespektim të kushteve për plasim të produkteve në programet audiovizuale dhe rregullave për shënimin e programeve që përmbajnë plasim produktesh.

Këshilli i Agjencisë, në seancën e 16-të mbajtur më 10 prill, bazuar në raportet e rregullta dhe kontrollet administrative dhe mbikëqyrjet programore, shqiptoi 11 masa paralajmërim publik për TV Klan Maqedoni, TV Kompani 21-M, TV Shenja dhe Nasha TV.

Për TV Kompani 21-M janë shqiptuar katër masa vërejtje publike: për mospublikim impresium në dy emisione; mospërmbushje të detyrimeve lidhur me lojërat shpërblyese dhe përdorimin e shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar; për fshehje të komunikimit komercial audiovizual në emision informativ aktual-shoua dhe për transmetimin e reklamave pop-ap në ekran të ndarë, midis të cilave nuk kalon periudha e përcaktuar prej së paku 15 minutash.

Katër masa vërejtje publike janë shqiptuar dhe për TV Klan Maqedoni për mospublikim impresium në emisione arsimore dhe aktuale-informative; transmetim të programit të kategorisë së tretë në kohë të papërshtatshme; mospublikim të informacionit që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve dhe mospërmbushja e detyrimit për transmetim minimum 30% të veprave audiovizuale maqedonase.

Dy masa vërejtje publike janë shqiptuar ndaj TV Shenja për mospublikim impresium të programit dokumentar dhe për mospërmbushje të detyrimit për transmetim minimum 30% të veprave audiovizuale maqedonase. Masë vërejtje publike është shqiptuar ndaj Nasha TV për shkelje të dispozitave për kohëzgjatjen midis pop-ap reklamave me ekran të ndarë në tre emisione.

